

PAKO EDUKATIVE

Pyetje dhe përgjigje për fëmijët dhe të rinjtë



QËLLIMI I PAKOS EDUKATIVE:

Pakoja edukative synon të rris ndërgjegjësimin mbi Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe mendimin kritik mbi temat e ndërlidhura me grupin e synuar të nxënësve të nivelit shkollorë të mesëm i ulët dhe palët tjera të interesuara prindër dhe mësime dhënë. Pakoja edukative do të përfshijë një prezantim mbi bazat e të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve si dhe një qasje për e të menduarit kritik për edukimin e të drejtave të fëmijët.

PËRMBAJTJA E PAKOS EDUKATIVE:

Pakoja edukative përmban informacione të përgjithshme dhe specifike që ndërlidhen në informacionin se si dhe kur linden të drejtat e njeriut; struktura e përgjithshme e të drejtave të njeriut; lindja/ndarja e të drejtave të fëmijëve si kategori e veçantë; nevoja për të pasur të drejta të veçanta për fëmijë.

Me fokus të veçantë do të pasqyrohen të drejtat e fëmijëve në praktike dhe zbatueshmëria e tyre duke nisur nga katër parimet e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës me theks të veçantë parimi i pjesëmarrjes së fëmijëve pasi që pakoja do të fokusohet në ofrimin e ideve që fëmijët vet të ndërmarrin iniciativa për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Theks të veçantë do t'i kushtohet diskutimit për mos respektimin e të drejtave të fëmijëve apo shkeljen e të drejtave që shpesh e sjellë dhunën dhe rreziqet tjera të mundshme. Vështrim kritik për trajtimin me problemet/dukuritë e dhunës në shkolla, ndëshkimin trupor, keqpërdorimi me substancave narkotike, abuzimin digjital, radikalizmin dhe ekstremizmin, etj.



HISTORIA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Shumë njerëz e shohin zhvillimin e legjislacionit të të drejtave të njeriut si një nga arritjet më të mëdha të shekullit të njëzetë. Por rregullimi i marrëdhënieve ndër-njerëzore fillon me historinë e hershme të njerëzimit. Të drejtat dhe liritë e njeriut, kanë qenë të rregulluara në bazë të kanuneve, normave fetare dhe ligjeve lokale të përcaktuara nga mendimtarë dhe prijës të kohës.

Pabarazia në mes të njerëzve ka qenë shumë e theksuar duke u ndarë në grupe shoqërore me të gjitha të drejtat dhe grupe që nuk gëzojnë asnjë të drejtë.

Në periudhën moderne deri në kohën e sotme kemi të zhvilluar një gamë të gjerë të drejtave të njeriut me një shtrirje të gjerë dhe aplikueshmëri globale.

Parimet bazë të të drejtave të njeriut janë:

E DREJTA PËR JETË

BARAZIA

LIRIA

4 PARIMET E PËRGJITHSHME TË KONVENTËS "PËR TË DREJTAT E FËMIJËS"

Të drejtat e fëmijëve në Konventën "Për të drejtat e fëmijës" pasqyrojnë katër parime bazë:

- 1 **Mos diskriminimin (neni 2):** Të gjitha të drejtat aplikohen për të gjithë fëmijët pa dallim. Shteti ka detyrimin për të mbrojtur fëmijët nga çdo formë diskriminimi.
- 2 **Interesin më të lartë të fëmijës (neni 3):** Faktori përcaktues në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, duhet të jetë interesi më i lartë i tij apo i saj. Në të gjitha rastet, interesat më të lartë të fëmijëve kanë përparësi në krahasim me interesat e të rriturve të përfshirë (p.sh.: prindërit, mësuesit, kujdestarët). Megjithatë, pyetja si të vendoset interesi më i lartë i fëmijës mbetet vështirë për t'u përcaktuar dhe mbetet e hapur për diskutim.
- 3 **Të drejtën për të jetuar, për të mbijetuar dhe për të zhvilluar (neni 6):** E drejta e fëmijës për të jetuar është e pamohueshme dhe është detyrimi i shtetit për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës. Kjo do të thotë që fëmijët nuk mund t'i nënshtrohen dënimit me vdekje apo dhënies fund të jetës.
- 4 **Respektimin e pikëpamjeve të fëmijës (neni 12):** Fëmija ka të drejtë të shprehë një mendim dhe t'i merret parasysht mendimi për çdo çështje e cila ndikon në të.



INSTRUMENTET DHE KONVENTAT KRYESORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT¹

Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve;

Njohja e dinjitetit të lindur dhe njohja e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme për të gjithë anëtarët e familjes njerëzore përbën themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes në botë.

Hyrja, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Të drejtat e njeriut i gëzojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, në mënyrë universale dhe të përjetshme.

Të drejtat e njeriut janë universale: Ato mbeten gjithmonë të njëjta për të gjithë qeniet njerëzore kudo në botë. Ti nuk ke të drejta të njeriut për shkak se je shtetas i një vendi, por sepse ti je anëtar i familjes njerëzore. Kjo do të thotë që fëmijët kanë të drejta të njeriut, sikurse edhe të rriturit.

Të drejtat e njeriut janë të patjetërsueshme: Nuk mund t'i humbësh më këto të drejta, veçse kur pushon së qeni qenie njerëzore.

Të drejtat e njeriut janë të pandashme: asnjëri nuk mund të të heqë një të drejtë, sepse është "më pak e rëndësishme" apo "jo e domosdoshme".

Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura apo komplementare: Të drejtat e njeriut formojnë së bashku një kuadër plotësues. Për shembull, mundësia e fëmijëve/ të rinjve për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për çështjet që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga e drejta e tyre për t'u shprehur, për t'u shoqëruar me të tjerët, për t'u arsimuar, madje dhe për të marrë vendime për gjërat e nevojshme në jetë.

Konventa "Për të drejtat e fëmijës" e njohur, gjithashtu, si Konventa e Fëmijëve e përkufizon

¹ Konventat kryesore të Kombeve të Bashkuara të të drejtave të njeriut, <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20e%20Njeriut%20%281948%29.pdf>

Konventa "Për parandalimin dhe ndjekjen e krimit të gjenocidit", 1948 Konventa "Për me statusin e refugjatëve", 1951 Konventa "Për skllavërinë", 1926, ndryshuar me protokoll, 1953 Pakti ndërkombëtar "Për të drejtat civile dhe politike", 1966 Konventa ndërkombëtare "Për eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit racial", 1966 Konventa "Për mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit", 1968 Konventa "Për eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ndaj grave", 1979 Konventa "Kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese", 1984 Konventa "Për të drejtat e fëmijës", 1989 Konventa "Për të drejtat e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre", 1990 Konventa "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", 2006. Shënim: Data i referohet vitit të miratimit të konventës nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

fëmijën si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç dhe pohon se fëmija i gëzon plotësisht të drejtat e njeriut. Ajo përmban 54 nene të të drejtave të fëmijëve që mund të ndahen në tri kategori të përgjithshme, shpeshherë të njohura si “tri P-të”1:

Mbrojtje (protection), që garanton sigurinë e fëmijëve dhe që mbulon çështje specifike, si: abuzimi, neglizhenca dhe shfrytëzimi.

Përkujdesje (provision), që mbulon nevojat e veçanta të fëmijëve, si: arsimimi dhe kujdesi shëndetësor.

Pjesëmarrje (participation), që njeh kapacitetin në zhvillim të fëmijës për të marrë vendime dhe për të marrë pjesë në shoqëri, ndërsa ai apo ajo i afrohet moshës së pjekurisë. Të drejtat e njeriut janë të ndërvarura apo komplementare: Të drejtat e njeriut formojnë së bashku një kuadër plotësues. Për shembull, mundësia e fëmijëve/ të rinjve për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve për çështjet që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga e drejta e tyre për t’u shprehur, për t’u shoqëruar me të tjerët, për t’u arsimuar, madje dhe për të marrë vendime për gjërat e nevojshme në jetë.




PO NË KOSOVË ME CILIN LIGJ MBROHEN FËMIJËT DHE TË DREJTAT E TYRE?

Në korrik të 2020 ka hyrë në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Ky ligj mund të gjendet në ueb-faqen e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës duke ndjekur vegëzen:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>



PYETJE DHE PËRGJIGJE PËR TË NXITUR TË MENDUARIT KRITIK

1. Çfarë është dhuna në shkolla?
2. Si mund të vetëmbrohem nga dhuna në shkolla?
3. A duhet të ngacmojmë shokët/shoqet në shkollë?
4. Çfarë është ndëshkimi trupor?
5. A ndikon për të keq ndëshkimi trupor tek ne/fëmijët?
6. A është i ndaluar ndëshkimi trupor sipas ligjit në Kosovë?
7. Pse disa arsimtarë ende nuk mund të i rezistojnë përdorimit të ndëshkimit trupor?
8. Disa njerëz mendojnë se ndëshkimi trupor është pjesë e edukatës dhe kulturës sonë? A duhet të ndryshohet kjo qasje në Kosovë?
9. Çfarë janë substancat narkotike?
10. Pse duhet të kemi kureshtje për dukuritë negative vet shkatërruese?
11. Gjatë disponimit me muzikë, drogat paraqiten si diçka moderne? A i bën fëmijët apo njerëzit të duken më modern nëse i përdorin.
12. Si duhet të veprojmë nëse përdorim substancë narkotike?
13. Çfarë është radikalizmi dhe ekstremizmi?
14. Çfarë është abuzimi tek fëmijët dhe pse ndodhë?
15. Si mundet familja, shoku, shoqja, mësimdhënësit apo rrethi ku jeton fëmija të identifikoj disa nga shenjat që një fëmijë po përdor abuzim?
16. A e dimë ne çfarë është abuzimi digjital?
17. Si ta parandalojmë abuzimin digjital?
18. A duhet dhe ku mund të kërkojmë ndihmë për dhunën që po e përjetojmë ne apo shoqëria për rreth nesh?



ÇFARË ËSHTË DHUNA NË SHKOLLA?

Dhuna në shkolla është proces i cili manifestohet në shumë forma dhe të gjithë fëmijët janë të rrezikuar që në momente të caktuara të jenë të prekur nga forma të caktuara të dhunës.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e përkufizon dhunën si: Përdorimi i qëllimshëm i forcës ose fuqisë fizike kundër vetes, një tjetër personi, apo kundër një grupi ose komuniteti, ku rezulton ose ka gjasa të larta që të rezultojë në lëndime, vdekje, dëme psikologjike, zhvillim ose privim të pamjaftueshëm.²

Llojet e dhunës në shkolla janë të formave të ndryshme të dhunës fizike, mendore, seksuale dhe neglizhimi.

Dhuna fizike - Përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike, i përdorur me potencialin për të shkaktuar dëm, lëndim, paaftësi ose vdekje.

Dhuna seksuale - Përfshin një akt seksual që kryhet ose tenton kundër një viktime që nuk ka dhënë pëlqimin e lirë ose që nuk është në gjendje të pranojë ose refuzojë.

Dhuna psikologjike (e njohur edhe si abuzimi emocional ose mendor) - Përfshin komunikimin verbal dhe joverbal që përdoret me synimin për të dëmtuar një person tjetër mendërisht ose emocionalisht ose për të ushtruar kontroll mbi një person tjetër.

Neglizhimi - Një lloj abuzimi që ndodh kur dikush ka përgjegjësinë për të siguruar kujdesin për një individ që nuk është në gjendje të kujdeset për të, por nuk e bën këtë.


Të gjitha këto lloje të dhunës që i përmendem më lartë, është dëshmuar nga hulumtime³ të ndryshme se janë prezent në shkolla. Kështu që, në njëfarë kuptimi, nuk mund të flitet për dhunën në shkolla si kategori e veçantë e dhunës, por një mjedis ku të gjithë këto lloje të dhunës janë prezent. Andaj, është e rëndësishme që këto lloje të dhunës të dimë t'i identifikojmë dhe dallojmë në mënyrë që të jemi të vetëdijshëm që të mos jemi as shkaktar e as viktimë e këtyre sjelljeve përkatëse.

² VËLLIMI 1 - Parandalimi i dhunës në shkolla dhe shoqëri - materiale përkrahëse për mësimdhënësit të edukatës qytetare të shkollave fillore në Kosovë, faqe 22.

³ Dokument bazë për hartimin e platformës së Komunes së Prishtinës, për siguri në shkolla 2015-2018, faqe 5.

Dhuna tek fëmijët merr forma të ndryshme dhe influencohet nga një seri faktorësh të ndryshëm, nga karakteristikat personale të viktimës dhe dhunuesit, nga kultura dhe mjedisi fizik ku ndodh. Megjithatë duhet pasur parasysh se një pjesë e madhe e dhunës në shkolla mbetet e pa raportuar për shumë arsye. Një arsye është frika: shumë fëmijë kanë frikë të raportojnë incidentet e dhunës fizike apo mendore ndaj tyre apo edhe nuk kanë informacionin e duhur si dhe ku të raportojnë rastet e abuzimit apo dhunës.


Shkaqet apo faktorë që e shkaktojnë dhunën mund të jenë si nga ata individualë, ashtu edhe familjarë dhe shoqërorë, ku këta të fundit lidhen kryesisht me pasojat e luftës, pabarazinë shoqërore-ekonomike, urbanizmin dhe mbipopullimin, zhvillimin e shpejtë ekonomik dhe teknologjik, disponueshmërinë e armëve, etj.



SI MUND TË VETËMBROHEMI NGA DHUNA NË SHKOLLA?


Në shkollë në mund të vetëmbrohem duke:

- Biseduar me arsimtarin kujdestar ose ndonjë arsimtar tjetër me të cilin ndjeheni më të lirë të bisedoni sepse të rriturit do të kuptojnë çështjen tuaj ata do të kenë më të lehte për të ju ndihmuar për të zgjidhur problemin dhe përmirësojnë situatën.
- Duke kërkuar ndihme nga pedagogu i shkollës për shqetësimet të cilat i keni.
- Tek psikologu i shkollës në rast se keni psikolog te shkollës.
- Duke mësuar dhe pasur njohuri për të drejtat e tua si fëmijë/rinj.
- Komunikim dhe mirëkuptim për ndjenjat e të tjerëve.
- Mundohuni të evitoni konfliktet duke mos përhapur fjalë për të tjerët.
- Vetë reflektoni.



A DUHET TË NGACMOJMË SHOKËT/SHOQET NË SHKOLLË?

Bota plotësohet dhe është me e bukur nga llojllojshmëria që ka nga njerëzit me tipare të ndryshme apo unike. Andaj, ne duhet që shoqet dhe shokët e shkollës t'ij pranojmë të tjerët ashtu siç janë me veçoritë e tyre pavarësisht që nuk jemi të njëjta. Nëse ne si fëmijë/ të rijnë duam të jetojmë në paqe dhe harmoni ne duhet të kemi mirëkuptim për të tjerët dhe të mos bëjmë dallime gjinore, etnie, fetare ose në bazë të aftësive të tyre. Nëse nuk arrijmë të respektojmë këto dallime ndërmjet veti, atëherë në shoqërinë tonë do të jenë prezentë cilësi negative si: ngacmimet, përqeshja, përdorimi i pseudonimeve denigruese, manipulimit psikologjik, dhuna fizike apo përjashtimin social, sjellje këto të cilat kanë pasoja negative edhe tek ai/ajo që ushtron bullizem po ashtu edhe tek shoqet/ shokët që e pësojnë atë. Disa nga efektet negative të bullizmit janë: performanca e dobët në shkollë, ndryshime emocionale, ankth, inferioritet, madje edhe trauma të ndryshme të cilat mund të ndikojnë dukshëm në formimin e shëndoshë të individit.




ÇFARË ËSHTË NDËSHKIMI TRUPOR?

'Ndëshkimi trupor' nënkupton dënimin e dikujt duke përdorur forcë fizike në atë mënyrë që nënkupton lëndimin ose mundimin e tyre. Çdo dënim që përdor forcë është ndëshkim trupor, sado i lehtë që të jetë ai. Për shembull, nëse një fëmijë rastësisht e thyen gotën e tij/saj, vizaton në muret e dhomës, hidhet nga divanet apo karriget në shtëpi dhe prindi i tij/saj e godet në dorë ose në pjesë të tjera të trupit për ta ndëshkuar, ky është ndëshkim trupor.

Ndëshkimi trupor shpesh merr formën e goditjes ndaj fëmijëve. Mirëpo, mund të merr edhe forma të tjera (për shembull: goditja me këmbë e fëmijëve, pickimi i dorës, ngrehja e veshëve, shkulja e flokëve, hedhja e papuçes drejt fëmijës, djegia e dorës apo ndonjë pjesë tjetër të trupit, etj.) Ndërsa ndëshkimi trupor në shkollë është kur një fëmijë nuk e di përgjigjen e një pyetjeje dhe një mësues ja goditë me thupër duart, e detyron që të qëndrojë në një këmbë për një kohë të gjatë, vendosja apo ulja e nxënësit në bankën e parë ose të fundit të klasës, ky është ndëshkim trupor po ashtu.

Ekzistojnë edhe forma të tjera të ndëshkimit që nuk janë trupore, mirëpo të cilat janë po aq mizore – për shembull, frikësimi i qëllimshëm i fëmijëve duke ju thënë se do të dërgojmë në vende të errëta larg shtëpisë nëse nuk ju binden prindërve ose vënia e tyre në siklet/turpërimi para familjareve të tjerë ose shoqërisë. Edhe ky lloj ndëshkimi është shumë i parespektueshëm dhe denigrues për fëmijët aq sa edhe ndëshkimi trupor fizik. Ndëshkimi trupor i fëmijëve mund të ndodhë në vende të ndryshme – përfshirë shtëpinë, shkollën, apo vendet e tjera ku ofrohet kujdes për fëmijët.

Andaj, të gjitha llojet e ndëshkimit janë të pajustificueshme dhe duhet të mos tolerohet përdorimi i tyre.



A NDIKON PËR TË KEQ NDËSHKIMI TRUPOR TEK NE/ FËMIJËT?

Po, ndëshkimi trupor ndikon për të keq tek fëmijët! Shpesh herë të rriturit nuk e kuptojnë se ndëshkimi trupor përcillet me dhimbje emocionale dhe fizike. Ata mendojnë se një shuplakë nuk paraqet një sjellje jo të gabuar por në fakte, ata nuk e kanë të qartë pasojat që mund të i ketë ajo shuplake, goditje, pickim tek fëmija.

Fëmijët goditjen e prindërit apo të mësuesit apo të kujtdo qoftë e përjetojnë me dhimbje emocionale duke u ndier të dobët, të pafuqishëm, dhe të poshtëruar. Po ashtu edhe nga aspekti fizik dhembja gjatë goditjes mund të ngalësojë procesin e rritjes dhe zhvillimit të trupit të tyre.



A ËSHTË I NDALUAR NDËSHKIMI TRUPOR SIPAS LIGJIT NË KOSOVË?

Po, me Ligjin nr. 06/I-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ndalohet ndëshkimi trupor dhe masat disiplinore të cilat dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor të fëmijës, duke përfshirë format e dhunës fizike dhe mendore, si dhe sjellje që e degradojnë, turpërojnë dhe e vënë fëmijën në situatë të dobët, janë të ndaluara në secilin ambient në shtëpi dhe familje, institucione edukativo arsimore, në institucionet e kujdesit, organet e rendit dhe sistemit të drejtësisë, në ambientet e punës dhe komunitetit.⁴




⁴ Neni 38, Ndalimi i Ndëshkimit Trupor, Ligji për Mbrojtje të Fëmijës, 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

PSE DISA ARSIMTARË ENDE NUK MUND TË I REZISTOJNË PËRDORIMIT TË NDËSHKIMIT TRUPOR?

Shumë nga stafi arsimor e kanë të vështirë të i rezistojnë përdorimit të ndëshkimit trupor për arsye sepse ata besojnë se përmes ndëshkimit trupor fëmijët do të disiplinohen dhe do t'u binden kërkesave të tyre.

Shpesh herë përdorimi i ndëshkimit trupor nga arsimtaret vie nga shumë arsye si mos durimi i arsimtarëve për të trajtuar rastet me qetësi, zemërimi i brendshëm i arsimtareve kundrejt fëmijëve, nuk njohin forma të tjera të edukimit, përvojat e tyre personale si fëmijë, etj.



DISA NJERËZ MENDOJNË SE NDËSHKIMI TRUPOR ËSHTË PJESË E EDUKATËS DHE KULTURËS SONË? A DUHET TË NDRYSHOHET KJO QASJE NË KOSOVË?

Shumë njerëz në Kosovë mendojnë dhe pajtohen që ndëshkimi trupor duhet të përdoret tek fëmijët pasi kjo ka qenë pjesë e edukatës sonë familjare dhe kulturës sonë. Mirëpo me zhvillimin e shoqërisë dhe njohjen e të drejtave të njeriut edukimi dhe disiplinimi nuk duhet të ngatërrohet me ndëshkimin trupor apo dhunën.

Familja si bërthama e shoqërisë duhet të trajtojë me respekt dhe dashuri anëtarët e saj për nga brenda dhe jashtë saj. Familja duhet të ruaj traditat dhe kulturën po asnjëherë të shkele të drejtat themelore të fëmijëve në rritje të qetë dhe të lumtur të tyre.


Andaj, respektimi i të drejtave themelore të çdo anëtari/re të familjes është obligim njerëzor përpara se që është ligjor!



ÇFARË JANË SUBSTANCAT NARKOTIKE?

Drogat janë substanca psikoaktive të cilat ndryshojnë funksionimin e sistemit biologjik dhe veprojnë në tru duke shkaktuar efekte të ndryshme. Shumë substanca mund të shërbejnë si droga, përfshirë qetësuesit e dhimbjeve, alkooli, nikotina, kafeina, antibiotikët, drogat klinike dhe drogat e paligjshme psikoaktive. Përdorimi i drogave mund të shkaktoj probleme shëndetësore në organizimin e njeriut. Natyra dhe shkalla e dëmtimit varet nga lloji i drogës, mënyra e përdorimit dhe përdorimi i shpeshte.

Disa lloje të drogave mund të dëmtojnë mushkëritë, si p.sh. tymosja e duhanit mund të shkaktoj kancerin, dëmtimin e rrugëve të mushkërisë, infeksione të tjera si dhe kollitjen, ndërsa alkooli dhe mund të dëmtojë mëlçinë. Dëmtimi i mëlçisë shkakton uljen e qëndrueshmërisë së përgjithshme të organizmit dhe rrit mundësitë për shfaqje të sëmundjeve të tjera. Nga aspekti i shëndetit mendor dhe funksionimit të trurit përdorimi i drogave e çrregullon punën e neurotransmetereve. Neurotransmetet janë substanca kimike të trurit të cilat mundësojnë bartjen e informatave në tru dhe trupin tonë. Në rast se një person përdor droge, ai/ajo ka lejuar të "mësoj" trurin se drogat janë burim kryesor i kënaqësisë dhe me pas personi bëhet i varur nga drogat dhe nuk ndien me kënaqësi nga jeta normale.



Megjithatë tretmani i ndihmon njerëzit të ndërprejnë përdorimin e drogave prej të cilave ata janë të varur. Ekzistojnë lloje të ndryshme të trajtimit të varësisë: psikoterapia, terapia me medikamente. Efekti trajtimit është më i madh kur kombinohen këto dy lloje të trajtimit. Tretmani i ndihmon klientëve për të mësuar mënyra për të luftuar nxitësit të cilët i shtyjnë personat për të përdorur drogë dhe për të ri fituar kontroll mbi jetën e tyre.

Keqpërdorimi me llojin e drogës dhe substanca narkotike është problem i madh shoqëror dhe shëndetësor në mbarë botën, ngase pasojat që dalin nga efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga kjo dukuri, janë shumëfish të dëmshme për vetë personin, familjen dhe shoqërinë në tërësi, si dhe ndikon në rrezikimin e sigurisë shtetërore.

Shpeshherë, për arsye parimore, nxënësit nuk janë të motivuar t'i diskutojnë temat që lidhen me përdorimin e substancave. Disa mund të besojnë që vetë diskutimi për këto substanca, qoftë edhe në klasë, mund t'i motivojë njerëzit që të fillojnë t'i përdorin ato. Të tjerët mund të thonë që vetë të mësuarit për këto substanca nuk ka ndonjë rëndësi për nxënësit, sepse gjithsesi ata nuk do t'i përdorin ato.



PSE DUHET TË KEMI KURESHTJE PËR DUKURITË NEGATIVE VETË SHKATËRRUESE?

Shume fëmijë/të rinjë janë kureshtar për të përdorur substancat narkotike vetëm për të provuar ndjesinë e kënaqësisë të cilën supozohet se do ta përjetojnë me përdorim të tyre. Mirëpo, realiteti është se edhe dozat me te vogla të marruara apo provuara japin efekt në shtim të përdorimit të sasisë dhe sa me shumë qe trupi pranon substance narkotike aq me i varur bëhet. Efektet e drogës janë në çrregullime në sjellje, gjendje të ndryshuar emocionale, dëmtim të organeve të brendshme si mushkëritë nga përdorimi i marihuanes, veshkave nga kokaina, heroina dhe të tjera.

Për këtë dukuritë negative që ndihmojnë në shkatërrimin e vetes dhe të ardhmes tonë dhe të shoqërisë nuk duhet të kenë hapësirë në imagjinatën e mendjes së shëndoshë.



GJATË DISPONIMIT ME MUZIKË, DROGAT PARAQITEN SI DIÇKA MODERNE? A I BËN FËMIJËT APO NJERËZIT TË DUKEN ME MODERN NËSE I PËRDORIN?


Gjatë disponimit me muzikë përdorimi i drogës mund të paraqitet si diçka moderne por në shoqëri përdorimi i tyre nuk na bën që të shihemi nga njerëzit me të zhvilluar ose emancipuar për kohën që po jetojmë. Sipas shoqërisë për të qenë modern në shekullin 21 një i ri/re modern është kur personi është i edukuar, shkolluar, di të komunikojë qartë me të tjerët, ka shoqëri, është kreativ, zgjidh problemet me logjikë, merret me sport, din të gatuan ushqime të shëndetshme, ka aftësi të mira digjitale, etj.



SI DUHET TË VEPROJMË NËSE PËRDORIM SUBSTANCE NARKOTIKE?

Nëse ju ndodh një situatë e tillë e përdorimit të substancave narkotike ajo çka duhet të bëni është:

- Të flasësh me familjen ose me miqtë e afërm dhe të besueshëm.
- Ruani qetësinë, mos i lëshoni pe mendimeve tuaja dhe ndjenjave negative për këtë incident.
- Bëni një përmbledhje të situatës që ju çoj në konsumim.
- Bëni një plan për të rimarrë veten menjëherë.
- Kërkoni ndihmë tek njerëzit e besueshëm. Nëse vetë nuk ja dilni dot ta zgjidhni problemin atëherë të tjerët mund t'ju vijnë në ndihmë në mënyrë efektive.



ÇFARË ËSHTË RADIKALIZMI DHE EKSTREMIZMI?

Radikalizmi nënkupton një proces psiko-social në rritje drejtë ideologjive socio-politike. Radikalizmi dhe ekstremizmi janë shndërruar në një sfidë të përgjithshme botërore të shoqërisë. Për shkak të përhapjes, dinamikës dhe prirjeve që kanë pasur vitet e fundit këto fenomene, si dhe për shkak të pasojave tepër të rrezikshme për jetën dhe sigurinë e njerëzve. Shkaqet e tyre janë nga më të ndryshmet. Ato lidhen me globalizmin e pakontrolluar, krizat afatgjata humanitare, ndryshimet kaotike shoqërore, thyerjen e sistemit të vlerave, luftërat, krimet masive të luftës etj.⁵

Faktorët e përgjithshëm, të cilët ndikojnë në radikalizimin e të rinjve janë:

- kriza e identitetit;
- kriza personale;
- rrethanat personale;
- aspiratat e papërbushura dhe, kriminaliteti.



⁵ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, "Ekstremizmi i dhunshëm sfida madhore e kohës sonë" - MANUAL PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE: http://www.ahc.org.al/ep-content/uploads/2018/06/Manual_Ekstremizmit-1.pdf

ÇFARË ËSHTË ABUZIMI TEK FËMIJËT DHE PSE NDODHË?


Abuzim i fëmijës⁶ konsiderohet çdo lloj forme e keqtrajtimit ose neglizhencës që shkakton si pasojë dëmtimin ose plagosjen e fëmijës, e cila nuk mund të shpjegohet në mënyrë të arsyeshme. Abuzimi i fëmijës përfshin: abuzimin fizik, emocional dhe seksual, si dhe neglizhencën. Dhuna ndaj fëmijëve shfaqet dhe realizohet në disa forma: emocionale, fizike, seksuale dhe në formën e neglizhencës.

Disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet që shpijnë tek abuzimi mund të jenë:

Faktorët individual- dija, qëndrimet, mendimet për dhunën dhe mangësitë e aftësive, aftësitë e kufizuara të komunikimit, përdorimi i drogës dhe alkoolit, të qenurit dëshmitar i dhunës apo të qenurit viktimë e dhunës ndër personale,

Faktorët që rrjedhin nga familja- mungesa e dashurisë dhe e mbështetjes prindërore; eksperiencia me dhunën në shtëpi; dënimi fizik dhe keqtrajtimi i fëmijëve; prindërit dhe vëllezërit e motrat, të përfshirë në sjellje kriminale.;

Faktorët shoqërorë- pabarazia shoqërore-ekonomike, urbanizmi dhe mbipopullimi; zhvillimi i shpejtë ekonomik, shoqëruar me nivel të lartë të papunësisë në mesin e të rinjve; ndikimet e mjeteve të informimit publik; normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme; mbajtja e armëve; situata e pas konfliktit.



⁶ Haxhiymeri. E., Kulluri. E., Hazizaj. A., 2005. "Abuzimi i fëmijëve në familje", CRCA, IRCCRA.

SI MUNDET FAMILJA, SHOKU, SHOQJA, MËSIMDHËNËSIT APO RRETHI KU JETON FËMIJA TË IDENTIFIKOJ DISA NGA SHENJAT QË NJË FËMIJË PO PËRJETON ABUZIM?

Disa nga treguesit e abuzimit fizik janë:⁷kocka të thyera, fraktura; mavijosje; gërvishtje, çjerrje; shenja djegieje; shenja mavijosje në formën e mjetit ose të gishtave në lëkurë; rrjedhje gjaku ose sëmundje të pashpjegueshme; deformime fizike; humbje ndjenjash.

Disa nga shenjat e mundshme të sjelljes së fëmijës si rezultat i dhunës fizike janë:

- qëndrimet e dëshpëruara, të tërhequra ose nën gjendjen e depresionit;
- bërja e një gjumi jo të qetë, me shqetësime;
- sjellja agresive;
- shfaqja e frikës ndaj disa të rriturve ose të rriturve në përgjithësi;
- frika nga kthimi në shtëpi i prindit/kujdestarit ose kthimi në shtëpi i fëmijës sikurse edhe frika nga kontaktimi me prindin/kujdestarin ose një anëtar i familjes;
- mungesa e besimit tek të rriturit ose vlerësimi i ulët për vetveten;
- qëndrimi shumë pasiv dhe ankimet e vazhdueshme;
- përdorimi i drogës dhe i alkoolit;
- largimi ose braktisja e vazhdueshme e shtëpisë etj.

⁷Protokolli i punës së punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve”, 2010. Ministria e Punës, Terre des Hommes, UNICEF.

Shenjat treguese të sjelljes të abuzimi seksual⁸

Shenjat dhe simptomat më specifike të abuzimit seksual janë dhimbje rektale ose gjenitale, gjakrrjedhje rektale ose gjenitale, prezenca e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme tek fëmijët e para pubertetit si dhe sjellje seksuale të parakohshme, veçanërisht nëse këto janë të vazhdueshme.

Simptomat e sjelljes që mund të paraqesë fëmija i abuzuar seksualisht janë të përmbledhura më poshtë. Është e rëndësishme të kujtohet që jo të gjitha shqetësimet e mëposhtme janë tregues të abuzimit seksual.

Disa nga shenjat e mundshme të sjelljes së fëmijës si rezultat i dhunës seksuale janë:

- Demonstron njëri nga dy ekstremet e aktivitetit (hiperaktiv ose të tërhequr);
- Manifeston vet-vlerësim të ulët;
- Tregon evidencë të marrëdhënive të cekëta me shokët;
- Shpreh ndjenja të përgjithshme faji apo turpi;
- Demonstron një shtrembërim të imazhit të trupit (vizatimet);
- Demonstron sjellje regressive;Duket i/e frikësuar gati fobik ndaj të rriturve;Shfaqë një keqësim/rënie në suksesin shkollor;
- Kanë një çrregullim të të ngrënit;
- Manifestojnë sjellje provokuese seksuale;
- Braktisë shtëpinë;

Treguesit e abuzimit psikologjik/emocional:

- vonesa në zhvillimin fizik, mendor dhe emocional;
- gjendje ankthi e vazhdueshme;
- vonesa në të folur ose në të shprehur të një mendimi;
- vetëvlerësim i ulët;
- përgjigje emocionale jo në përputhje me situatën e dhimbshme;
- agresivitet ose pasivitet ekstrem;
- abuzimi me substanca narkotike dhe alkoolin;
- largimi ose braktisja e vazhdueshme e shtëpisë;
- mungesë dëshire për të kryer aktivitete të ndryshme;

8 Shehu. E., Gramo. A.,2008. "Dhuna me bazë gjinore. Manual për punonjësit e shëndetësisë", Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë.

Shenja të mundshme të fëmijës së neglizhuar janë:

- veshja e fëmijës nuk është e përshtatshme me sezonin ose motin (kjo mund të ketë shkaktuar simptoma të tilla që përfshijnë të ftohtët, kollitje, pneumoni, djegie nga dielli, shenja që shkaktohen nga ngrica etj.);
- mungesë e mirëmbajtjes së higjiena personale e fëmijës (thonjtë të gjatë e të papastër, erë e keqe e trupit, flokë të pakrehur e të palarë, parazitë në kokë dhe në trup);
- mbikëqyret në mënyrë jo të mjaftueshme ose lihet në përkujdesje të një personi jo të përshtatshëm;
- ka probleme që tregojnë se nuk është trajtuar me ilaçe ose nga mjeku;
- është i/e kequshqyer (fëmija nën peshë dhe jo me zhvillimin e duhur sipas moshës, ka vështirësi në gjellitjen e ushqimit, është gjithnjë i lodhur e i këputur, trupi ka humbur tonet fëmijërore etj);
- vonesa ose mos vijim i rregullt në shkollë.



A E DIJMË NE ÇFARË ËSHTË ABUZIMI DIGJITAL?

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative në vitet e fundit i lidhur edhe me rritjen e nivelit të rreziqeve të shfaqura si rrjedhojë e qasjes jo të sigurt të fëmijëve në internet, në shumë vende të botës ka nxjerrë në pah rëndësinë e masave që duhet të merren me qëllim që të mbrohen fëmijët gjatë përdorimit dhe kërkimeve të ndryshme në internet. Duke pas parasysh se teknologjia po zhvillohet shpejtë dhe po ofron më shumë mundësi kërkimi, përqindja e kohës që fëmijët kalojnë para pajisjeve teknologjike po rritet e po ashtu edhe ndikimi saj tek fëmijët dhe adoleshentët.

Shpeshherë në faqet e lojërave në internet, rrjete sociale, YouTube apo adresa tjera tjera në internet ku fëmijët kalojnë mjaft kohë, ata ekspozohen ndaj dhunës dhe kërcënimeve që bëhet nga fëmijët e tjerë, shfaqja e materialeve me përmbajtje të papërshtatshme, keqpërdorimi i të dhënave personale, sulmi me virus të ndryshëm, etj. Prandaj fëmijët duhet pasur kujdes sepse përdorimi i pasigurtë i internetit mund të ketë pasoja negative për ta.

Dhuna kibernetike (cyberbullying) është terminologji në gjuhën angleze që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe të këqija, fotografi dhe video tronditëse të personat e panjohur. Dhuna kibernetike është përdorimi i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike (si p.sh. internetit apo telefonit mobil) nga fëmijët dhe adoleshentet për të ngacmuar, kërcënuar, munduar, poshtëruar, turpëruar apo përdorimi i ndonjë forme tjetër të dhunës ndaj një fëmije apo adoleshenti tjetër.

Ka shumë forma të abuzimit digjital mirëpo këto janë më të shpeshtat:

- Dërgimi i e-mailave që mund të jenë kërcënues apo shqetësues (p.sh. mesazhe fyese, raciste apo paragjykime të tjera);
- Dërgimi ose postimi i thashethemeve të shokët apo direkt të viktimave;
- Postimet në rrjetet sociale – p.sh. i sekreteve të dikujt (p.sh. Facebook ose Twitter);
- Fyerja e fëmijëve duke ju vënë nofka apo pseudonime përmes mesazheve, komunikimit në Chat, postimit në rrjete sociale, etj.;
- Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë, pa lejen e tyre (zakonisht fotografi turpëruese ose intime/personale) në internet;
- Krijimi i profileve apo ueb-faqeve të caktuara në internet, duke shënjestruar një individ apo grup të caktuar fëmijësh me qëllim talljeje apo fyerjeje.
- Fëmijët shpeshherë ngacmohen nëpërmjet internetit të motivuar nga zemërimi, hakmarrja ose inati. Nganjëherë ngacmojnë të tjerët për zbavitje apo ngase janë të mërzitur dhe kanë tepër kohë të lirë.

SI TA PARANDALOJMË ABUZIMIN DIGJITAL?

Hapat qe mund të ndërmerrni të parandaluar abuzimin digjital:

- Mos iu përgjigjeni ngacmuesve ose personave që nuk i njihni,
- Mos i lexoni mesazhet e tyre,
- Bllokoni ata persona dhe mos komunikoni me ta;
- Raportimi i menjëhershëm i ngacmimit;
- Asnjëherë mos u hakmerreni ndaj atyre që ju ngacmojnë;
- Mos i tregoni askujt fjalëkalimet tuaja, përveç prindërve tuaj;
- Është e rëndësishme t'ju tregoni prindërve tuaj nëse bëheni viktimë e ngacmimit;
- Ruani dëshmitë lidhur me ngacmimet online;
- Mundohuni t'a identifikoni personin i cili ju ngacmon!




A DUHET DHE KU MUND TE KËRKOJMË NDIHMË PËR DHUNËN QE PO E PËRJETOJMË NE APO SHOQËRIA PËR RRETH NESH?

Po, ju lutem drejtohuni te personat të cilëve i besoni më së shumti. Prindërit mund të ju mbrojnë dhe të ju udhëzojnë. Ndjhuni të lirë të bisedoni me prindërit tuaj, tregojuni atyre se çfarë po ndodh me jetën tuaj dhe me shoqërinë tuaj, çka shihni në rrethin tuaj shoqëror dhe çka ju frikëson.

Ju mund të drejtoheni edhe te gjyshja apo gjyshi, motra apo vëllai për të kërkuar ndihmë për vete. Ju mund t'í ndihmoni edhe shokut apo shoqes tuaj në raste kur vëreni se ata po abuzohen. Në ambientet shkollore ju mund t'í drejtoheni edhe mësuesit, ata do të dinë se si të veprojnë.

Po ashtu, institucionet përgjegjëse për reagim dhe raportim të dhunës janë:

- Institucioni arsimor - arsimtari/ja ose drejtori/esha i/e shkollës,
- Komuna - Qendra për punë sociale,
- Drejtoria komunale e arsimit,
- Policia e Kosovës,
- Shoqëria dhe komuniteti - vendi ku jetojmë,
- Mediat publike ose private,
- Ministria e shëndetësisë - institucionet shëndetësore familja,
- Ministria e arsimit dhe shkencës,
- Ministria e punës dhe mirëqenies sociale,
- Ministria e drejtësisë, shërbimi korrektues dhe shërbimi sprovues.



Ky botim është realizuar në kuadër të projektit PROtectChild, i financuar nga Qeveria Suedeze.

Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj.

Qeveria Suedeze jo domosdoshmerisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.